

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

Për:	Grup i Operatorëve Ekonomik: N.N.P. "CONSTRUMAX" & N.N.P. "EBK" me adresë në Suharekë
Nga:	Jetulla Kabashi – Menaxher i Prokurimit – Komuna e Rahovecit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	21.12.2018

Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për ri-shqyrtim** të datës: 17.12.2018, të parashtruar nga Grup i Operatorëve Ekonomik: N.N.P. "CONSTRUMAX" & N.N.P. "EBK" me adresë në Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Ndërtimi i Shkollës Filllore në Reti**, me Numër të prokurimit: **623-18-8092-5-2-1**, Nr i brendshëm: **623-18-069-5-2-1**, nxjerr:

VENDIM

1. Refuzohet si e pa bazuar kërkesa e parashtruar e Grupit të Operatorëve Ekonomik: N.N.P. "CONSTRUMAX" & N.N.P. "EBK" me adresë në Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **Ndërtimi i Shkollës Filllore në Reti**, me Numër të prokurimit: **623-18-8092-5-2-1**, Nr i brendshëm: **623-18-069-5-2-1**, kundër Njoftimit për Kontratë të AK – së, të datës: 12.12.2018, të publikuar në web – faqe të KRPP – së.
2. Autortieti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim për Kontratë në aktivitetin e prokurimit: **Ndërtimi i Shkollës Filllore në Reti**, me Numër të prokurimit: **623-18-8092-5-2-1**, Nr i brendshëm: **623-18-069-5-2-1** dhe mbështet Njoftimin për Kontratë.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

A r s y e t i m

Grup i Operatorëve Ekonomik: N.N.P. "CONSTRUMAX" & N.N.P. "EBK" me adresë në Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **Ndërtimi i Shkollës Fillore në Reti**, me Numër të prokurimit: **623-18-8092-5-2-1**, Nr i brendshëm: **623-18-069-5-2-1**, kundër Njoftimit për kontratë të aktivitetit të prokurimit të AK – së, të datës: 12.12.2018 të publikuar në web-faqe të KRPP – së, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: 17.12.2018, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042, në cilin pretendon se janë shkelur këto nenet:

- 1 Neni 1 i LPP-së – Qëllimi**
- 2 Neni 6 i LPP-së - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti**
- 3 Neni 7 i LPP-së - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi;**
- 4 Neni 59 i LPP-së- Ekzaminimi, Vlersimi dhe Krahasimi i Tenderëve**
- 5 Neni 72 i LPP-së – Dokumentacioni dhe informacioni shtesë;**
- 6 RrUOPP sipas pikës 39.3,39.4,39.**

Neni 1 – Qëllimi – nuk është shkelur sepse është propozuar për kontratë tenderi O.E. i cili është i Përgjegjshëm me çmim më të lirë.

Është respektuar **Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti** – është propozuar për kontratë Operatori Ekonomik që ka dhe çmimet të tregut, ndërsa oferta e juaj në disa pozicione ka të bëjë me çmime që nuk janë fare ekonomike dhe jo të harmonizuara me çmimet e tregut në Kosovë.

Neni 7 i LPP-së - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi – të gjithë Operator janë trajtuar në mënyr të barabart sikur se edhe ju O.E. N.N.P. "CONSTRUMAX" & N.N.P. "EBK" me adresë në Suharekë, kërkesa në FTD dhe Njoftim për Kontratë, ju nuk keni pru dëshmi të mjaftueshme, pra as kontrata as parakontrat të noterizuara dhe as dëshmi nga AKT – ja se këta punëtor kanë qenë në listë të pagave para datës së hapjes së tenderëve.

Neni 59 i LPP-së- Ekzaminimi, Vlersimi dhe Krahasimi i Tenderëve – është bërë për të gjithë Operatorat Ekonomik në mënyr të barabart sikur se edhe ju O.E. N.N.P. "CONSTRUMAX" & N.N.P. "EBK" me adresë në Suharekë, pretendimi i juaj për shkelje të dispozitave të shkeljes së nenit 59 nuk qëndrojnë sepse ekzistenca e këtyre dokumentave ku vërtetohet se nuk ka qenë para datës së hapjes së tenderit.

Pas kërkesës tonë për sqarim sipas LPP – së neni 72 ku dokumentet e ofruara nga ana juaj shifet kuart se këta Inxhiner nuk kanë qenë të regjistruar në ATK para datës së hapjes së ofertave, nuk janë prezantuar fare kontratat as para kontratat të noterizuara sipas kriterëve të kërkuara.

Librezat e makineris janë noterizuar pas kërkesës për sqarim.

Kundër këtij vendimi të AK ju munde të paraqitni ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP – së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e pranimit të këtij vendimi.

Jetulla Kabashi
Menaxher i Zyres se Prokurimit
Komuna e Rahovecit